



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 08-M/01-34626
Datë: 23.07.2025

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, 1 Rregullore (QRK) Nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të punës

Një (1) Zyrtar/e për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore në QKMF- Lipjan

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Zyrtari për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore ka autoritetin funksional mbi të gjitha aspektet e institucionit shëndetësor në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (SMC).
2. Harton planin institucional të SMC sipas Kornizës së aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) dhe monitoron zbatimin e planit të SMC në përmirësimin e performancës së institucionit në tërësi.
3. Bashkëpunon me udhëheqësin e institucionit shëndetësor në caktimin e komitetit të cilësisë, komisioneve tjera si atë për audit klinik dhe hulumtim, organizim të rishqyrtimit kolegjial dhe të ngjashme, të përcaktuara me statut apo akte nënligjore.
4. Merr pjesë në takimet e menaxhmentit dhe të komitetit të cilësisë dhe ofron këshillime dhe rekomandime për trupat menaxhuese, koordinatorin për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), profesionistët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët shëndetësor, me qëllim të zbatimit të standardeve sipas SMC.
5. Përcjellë zhvillimet e reja në SMC, evidenton nevojat për përmirësim dhe menaxhon dosjet për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore për institucionin shëndetësor.
6. Njofton për miratimin e Udhërrëfyesve Klinik, Protokolleve Klinike, Udhëzueseve, Procedurave Standarde Operative (PSO) si dhe dokumenteve tjera për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore dhe monitoron zbatimin e tyre në institucionin shëndetësor përkatës;
7. Kordinon mbledhjen dhe raportimin e të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme në procesin e licencimit dhe akreditimit të institucionit shëndetësor;
8. Kordinon matjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga institucioni shëndetësor përmes indikatorëve të përcaktuar nga MSh;
9. Vlerëson në mënyrë periodike fazën e zbatimit të planit të SMC së shërbimeve shëndetësore dhe nivelin e përputhshmërisë me standardet dhe kërkesat e monitorimit të nxjerra nga Departamenti i Cilësisë, Sigurisë, Akreditimit dhe Licencimit të Institucioneve Shëndetësore në MSh;
10. Incidentet kritike në veprimtarinë e institucionit shëndetësor i raporton menjëherë në kompetencë;

11. Raporton në baza javore, mujore, tre mujore, vjetore dhe sipas kërkesës në Komitetin për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore dhe mbanë në dizeni udhëheqësin e institucionit shëndetësor;

12. Raporton në baza tre mujore, vjetore dhe sipas kërkesës përmes udhëheqësit të institucionit shëndetësor në Departamentin e Cilësisë, Sigurisë, Akreditim dhe Licencim të Institucioneve Shëndetësore në MSh.

Kushtet dhe kriteret për Zyrtar/e për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore:

- Fakulteti Bachelor i Shkencave në Infermieri-Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës-valide
- Certifikata Shëndetësore jo me e vjeter se gjashtë muaj
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan jo me e vjeter se gjashtë muaj.
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune.
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë zotësi të plotë veprimit, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vërtetimi nga punëdhësi).
- **Paga mujore për Zyrtar/e për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore në QKMF-Lipjan:**

Koeficienti: Klasa H-17 koeficienti 6.40

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar.

Puna Provuere gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendrike, e drejta për aplikim nga data 24.07.2025 deri me 22.08.2025 që konsiderohet si dita e fundit e konkurimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Kandidatet të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet që diploma e tyre të jetë e njohur (nostifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

